



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.09.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit.

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Tatjana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Lorenc Luka, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Agron Çela dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Dorina Çinari – Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Agim Bregasi - Drejtor i Energjetikës dhe Eficiencës së Energjisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Fato Bunda – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Rolanda Hila – Specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ardian Islami - Pergjegjes Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Anisa Pina – Specialiste e medias në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Tedi Bushaj – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi - Përpara se të kalojmë te shqyrtimi i projektligjit, miratojmë procesverbalin e mbledhjes së ditës së djeshme.

A jeni dakord?

Miratohet.

Urdhëroni!

Ilir Beqaj – Unë do të kërkoja vëmendjen e të gjithë kolegëve që shërbimet e Kuvendit duhen falënderuar për *upgrade*-in që i kanë bërë pjesës audiovizive të pasqyrimin të veprimtarisë së komisionit, por informacioni që na vjen se në komisionin tonë pjesa video dhe mikrofonat ambientale janë në funksionim 24 orë, më duket e papranueshme.

Ato mund të jenë të komandueshme, se ne nuk jemi këtu *Big Brother*. Ne mund të mbarojmë mbledhjen dhe tre kolegë prej nesh mund të shfrytëzojnë këtë hapësirë për të diskutuar një çështje të caktuar. Kjo nuk ka pse të jetë e transmetuar në zyrën qendrore poshtë audio dhe video. Nuk më intereson fare nëse regjistrohet apo nuk regjistrohet, kështu që të lutem, nuk e di kolegët e tjerë çfarë opinioni kanë, por unë personalisht kërkoj që të komunikoni me sekretarin e përgjithshëm të Kuvendit për të vendosur një rregullore se si do të administrohet ky shërbim i ri që është i vlefshëm, i kërkuar, i vonuar, por ky nivel i ri, jashtë çdo lloj administrimi, në funksion të punës së komisionit, gjykoj se duhet të vlerësohet edhe një herë nga shërbimet e Kuvendit.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Faleminderit!

Në fakt, një sugjerim do të kisha për zotin Beqaj, që nëse ka ndonjë informacion shtesë, të cilin mund të na e bëjë me dije për mënyrën se si funksionon sistemi i ri, do ta vlerësonim shumë.

Akoma nuk është bërë trajnimi, zoti Beqaj, pra sistemi shërben për të regjistruar sipas sistemit të vjetër dhe besoj se javën tjetër një ekip teknikësh brenda dhe jashtë parlamentit do të vijë të na shpjegojë me detaje mbi sistemin e ri, mbi mikrofonat, mbi kamerat, mbi mënyrën se si regjistrohet dhe procedohet dhe, pasi ne të njihemi me këtë mënyrë funksionimi, mund të bëjmë sugjerimet tona, se mund të na thonë, për shembull, kush ju tha juve që mikrofonat shërbejnë 24 orë në 24 orë?

Gjithsesi, e mbajtëm shënim dhe në rastin më të parë kur të trajnohemi, shpresoj të mos mungojë asnjë nga deputetët, mund të paraqesim të gjitha shqetësimet.

Faleminderit!

Ilir Beqaj – Unë do të sugjeroja që testimin ata ta bëjnë me manekinë, jo me ne deputetët.

Eduard Shalsi – Testimi është diçka tjetër, se testimin e bëjnë vetë ata, nuk kanë ç'të testojnë me ne.

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave”.

Përpara se të kalojmë te ky projektligj, shërbimet e komisionit më thonë se nuk kemi votuar marrëveshjen e djeshme, ndërkohë që në dijeninë time e kemi votuar dje, e mbaj mend shumë mirë.

Për efekt të regjistrimit ndoshta mund ta bëjnë edhe një herë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...Kemi relator zotin Besnik Baraj. Të ftuar nga Ministria e Energjisë dhe e Infrastrukturës kemi: zonjën Çinari, zotin Bregasi, zotin Bundo, zonjën Hila dhe zonjën Pine. Nga Ministria e Financave kemi të ftuar zotin Bushaj.

Ju uroj mirëseardhjen në komision!

Pa humbur kohë do të doja t'i jepja fjalën relatorit zotit Besnik Baraj. Pastaj do të dëgjojmë përgjigjet e përfaqësuesve të ministrisë, pyetjet nga kolegët dhe në fund kemi diskutimet. Jeni dakord me rendin e ditës? Po.

Para se t'i jap fjalën zotit Baraj do t'u kërkoja punonjësve të ministrisë se në informacionin që do të japin nëse ka diçka që nuk e dinë është më mirë të mos e thonë. Informacioni që mbërriti tani është që të paktën në godinat e Qytetit Studenti nuk është për 2 mijë studentë, por është për 1 mijë studentë, gjë që me të drejtë çudinë e kolegut tonë dje e justifikoi përgjigjja e sotme. Jo çdo pyetje mund t'i dihet përgjigjja dhe është më korrekte të mos përgjigjeni për çështje që nuk i dini. Të mos kemi luhatje të tilla 1 mijë me 2 mijë me studentët, siç ishte impakti i djeshëm. Janë disa pyetje që ndoshta dalin edhe përtej informacionit që keni, por do të doja të ishit të vëmendshëm te pyetjet dhe sidomos te përgjigjet.

Zoti Baraj, keni fjalën.

Besnik Baraj - Faleminderit!

Unë kam thjesht një koment të shkurtër, lidhur me atë që tha zoti Beqaj, meqenëse ne jemi këtu para përfaqësuesve të ministrisë që kanë ndjeshmëri shumë të madhe për eficiencën e energjisë për monitorimin 24 orë, të monitorohet vetëm në atë periudhë për të optimizuar

konsumin e energjisë. Kolegët e departamentit përkatës ta optimizojnë këtë gjë, që të mos shpenzojmë energji në kushtet kur nuk ka njeri në komision.

Lidhur me projektligjin e sotëm, unë e kam parë, veçanërisht relacionin dhe pa dyshim që është një element shumë i rëndësishëm investimi që bëhet për digat, për sigurinë e tyre, aq më tepër që Shqipëria ka një numër të konsiderueshëm të digave, ndoshta më të madh sesa në disa vende të rajonit, por ajo që më shqetëson është që realisht nuk ka një institucion (nuk po flas për institucionet para viteve '90) që ka kapacitetet e nevojshme shkencore, profesionale dhe mund të vlerësojë gjendjen e digave sot. Kur them për digat sot nuk kam parasysh vetëm Fierzën, Komanin apo Vaun e Dejës, por kam parasysh disa qindra diga që ekzistojnë në Shqipëri që vërtet mund të kenë impakt (nëse ndodh ndonjë gjë) jo aq i rëndësishëm sa në digat e mëdha, por pa dyshim duhet të studiohen dhe të konsiderohen në mënyrë që të parandalojnë ndonjë fatkeqësi, e cila ka ndodhur në vende, siç është Italia apo ndonjë vend tjetër. Janë fatkeqësi që kanë një pasojë katastrofike, aq më tepër me digat tona. Ajo për të cilën do të kisha një lloj kërkesë nga ana juaj që shtrohet edhe në formën e pyetjeve, të them të drejtën relacioni për mua lë pak për të dëshiruar. Në çfarë kuptimi? Këtu bëhet fjalë për shtesë të dytë në fondet për sigurinë e digave. Pavarësisht se ju mund të thoni, se do të ishte mirë të shikonit ato përpara, por kur përgatitet një relacion, ai duhet të ketë edhe kronologjinë përpara.

Pra, të thuhet se deri tani për këtë lloj sektori janë investuar këto para. Shtesat e mëparshme mund të kenë qenë kaq, shtesa e dytë është kaq dhe kështu me radhë, perspektiva e investimeve financiare në këtë fushë. Falë ndihmës që na kanë dhënë këshilltarët e komisionit unë kam marrë një informacion në lidhje me fondet që janë parashikuar nëpërmjet marrëveshjeve të ndryshme, duke filluar nga viti 2008, 2012, 2015. Unë do të doja që të na jepnit një informacion të shkurtër në lidhje me këto fonde. Bie fjala: në vitin 2015 është bërë një marrëveshje me qeverinë gjermane në lidhje me një fond të konsiderueshëm për sigurinë e digave. Ndër të tjera, aty thuhej që, në qoftë se deri në 2017-ën nuk nënshkruhet marrëveshja me qeverinë gjermane, kjo marrëveshje shfuqizohet. Këto hua janë të leverdishme, janë për një sektor kaq të rëndësishëm, problematik, kritik, që kanë të bëjnë me elementë të sigurisë kombëtare. Na jepni një informacion edhe lidhur me këtë ecure. Çfarë ka ndodhur me fondet e 2008-ës, të 2012-ës e të 2015-ës. Në lidhje me këtë marrëveshje që ishte parashikuar me qeverinë gjermane, për një fond të konsiderueshëm, bëhej fjalë për 20 milionë euro, në ç'kushte jemi? Si ka ecur? Ku qëndron problemi? Tek ata apo te ne?

Më pas të kalojmë edhe te projektligji i sotëm, në të cilin bëhet fjalë për një shtesë të dytë. Unë do të doja të dija sa ishte shtesa e parë. Çfarë parashikohet? Ka ndonjë shtesë të

tretë? A mbulohen të gjitha digat në Shqipëri, jo vetëm Fierza, Komani, rehabilitimi i tuneleve të shkarkimit e të tjerë?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Baraj!

Atëherë fjala për përfaqësuesit. Do të flasë zoti... Në rregull!

Dorina Cinari – Faleminderit, zoti Baraj!

Për sa i përket pyetjes për digat, kemi institucione përgjegjëse në Shqipëri. Kemi Komitetin Kombëtar të Digave. Ky është një institucion, i cili ndodhet nën administrimin e ministrisë sonë. Zoti Bregasi do të përgjigjet në detaje.

Sa i përket cilësisë së relacionit teknik, jam në një mendje me ju. E kam bërë këtë koment përpara se të futeshim në komision, që relacioni nuk është i plotë. megjithatë, sot do t'ju përgjigjem për çdo pyetje teknike që mund të keni.

Kemi përfaqësuesit teknikë të KESH-it, të cilët do t'ju japin përgjigje edhe në lidhje me kronologjinë e investimeve. Është shtesë financimi. Ajo që dua të sqaroj unë, është se nën fokusin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë janë vetëm digat e hidrocentraleve, dhe diga hidrocentralesh kemi vetëm ato që janë në kaskadën e Drinit, pra tri diga të mëdha. Digat e tjera, të cilat janë diga që i përdor bujqësia, nuk janë në fokusin e ministrisë sonë, por të Ministrisë së Bujqësisë. Natyrisht, mbulohen nga Komiteti i Digave, por nën fokusin tonë janë digat e hidrocentraleve.

Tani për pyetjen në lidhje me Komitetin e Digave përgjigjet Agimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por aktualisht vetëm aty kemi diga-kaskadë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I sqarojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të hidrocentraleve mbi kaskadën e lumit Drin.

Agim Bregasi – Në përgjigje të pyetjes së fundit, por sidomos të zotit Baraj, që ishte më përgjithësuese, mund të themi se në territorin e republikës së Shqipërisë janë rreth 640 diga, të klasifikuara të mëdha e të vogla, sipas një parametri të lartësisë, nën 15 metra dhe mbi 15 metra. Duhet ta bëjmë të qartë se projektligji që ne sjellim sot është vetëm për digat që ndodhen nën administrimin e KESH-it, i cili është një operator me 100% kapitale shtetërore, por ne po flasim për një kredi shtetërore, që qeveria shqiptare e ka marrë nëpërmjet Ministrisë së Financave e që do t'i kalojë KESH-it me të njëjtët terma e kushte të

kredisë. Ne këtu po flasim vetëm për tri digat që janë nën administrimin e KESH-it, që është 100% shtetëror.

Për sa i përket pjesës tjetër, ka diga që janë ndërtuar nga koncesionarë privatë, ka edhe diga të mëdha që përfshihen në këtë kategori, por shumica janë diga që kanë qenë për ujitje, të cilat deri para vitit 2015 administroheshin nga Ministria e Bujqësisë, ndërsa në vitin 2015, të gjitha këto diga u kanë kaluar në administrim 61 bashkive.

Realisht, problemi i digave është shumë delikat dhe shumë i rëndësishëm,, siç u tha këtu, por pa e kaluar, le të themi, stafetën te Komiteti Kombëtar i Digave. Ju mund të kërkonti edhe një informacion më të hollësishëm nga Komiteti Kombëtar i Digave, sepse vërtet ata janë pjesë e ministrisë, por janë subjekt i Këshillit të Ministrave dhe kanë një organizim të tillë, sepse dikur ishin në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Telekomunikacionit ose thënë ndryshe e Transportit, ndërsa tani që jemi bashkuar, janë te ne, kanë edhe një sekretariat të Komitetit të Digave, i cili bën punën përgatitore. Në kuadër të këtij komiteti, është e drejta juaj t'i thërrisni për informacione më të detajuara, por me aq sa unë kam dijeni, ka filluar një punë shumë serioze dhe e detajuar për identifikimin e situatës së digave, sidomos të atyre që kanë kaluar në administrimin e bashkive.

Realisht, për të qenë të sinqertë, kapacitetet e bashkive nuk janë në atë nivel që duhet për të administruar diga të këtij karakteri, megjithatë nga ministria jonë, duke qenë se edhe sekretariati ndodhet në ministrinë tonë, iu kërkuar të gjitha bashkive se cilat ishin problemet që ata kishin për të gjitha digat, të cilat kishin kaluar në administrimin e tyre. Nga informacionet që janë mbledhur dhe janë skeduar, si dhe është bërë edhe raporti vjetor për këtë problem, janë grupuar problematikat që kanë ngritur bashkitë për gjendjen e digave, funksionimin e tyre, problemet e gatishmërisë, rrezikun që ato kanë e të tjera dhe në bazë të kësaj nga Komiteti Kombëtar i Digave do të jepen rekomandimet përkatëse, duke bërë edhe trajnime të strukturave dhe të drejtuesve të bashkive, por sidomos të degëve teknike që merren me administrimin ose me monitorimin e digave.

Është një punë voluminoze që ka filluar nga Komiteti Kombëtar i Digave, së pari, me identifikimin e të gjitha çështjeve, problematikat dhe më pas duke klasifikuar se cilat nga digat ose rezervuarët është në funksion apo është amortizuar si rezultat i mbushjeve dhe i aluvioneve gjatë 50 vjetëve të ekzistencës së tyre, cilat nga këto bashki ka probleme me ndërtimet poshtë digës dhe toka nuk ujitet më dhe më pas të merret një vendim se cilat prej tyre duhen abandonuar, duke marrë edhe masat e sigurisë për të mos pasur ngjarje të jashtëzakonshme për ata që ndodhen aty. Ne vërtet themi llumra, por këto llumra mund të

jenë të rrëshqitshme dhe në qoftë se i lemë pa mirëmbajtje mund të shkaktojnë katastrofa në ato zona.

Gjithashtu, duhet të bëjmë edhe dallimin, sepse nga ato 640 diga, hiq ato të sistemit energjetik, ku kanë qenë 8 hidrocentrale të shtetit, për pjesën tjetër ka pasur një projekt të Bankës Botërore me Ministrinë e Bujqësisë, për rehabilitimin e digave që kanë pasur problematika, sipas një investigimi që është bërë para disa vjetësh kur është dhënë kredia nga Banka Botërore. Deri tani janë rehabilituar 14 diga të sistemit të bujqësisë, që kanë të bëjnë me ndërhyrjet, riparimet, mbushjet e digave, të cilat mund të kenë qenë të dëmtuara nga erozioni, shumica ndodhet te portat e shkarkimit, mbushje, amortizim. Shumica e këtyre portave janë të ndryshuara e të shtrembëruara dhe ato realisht si shumë gjëra të tjera te ne kanë qenë jashtë vëmendjes.

Pra, me kalimin e tyre në administrim e bashkive, natyrisht hapet një kapitull i ri, i vështirë, ku shpesh edhe përfaqësuesit e bashkive thonë: kemi këtë problem, duke kërkuar fonde nga qeveria ose kërkojnë ndërhyrjen tuaj pa ditur realisht se çfarë kompetencash ka bashkia dhe se kush duhet të merret me këto probleme, ose identifikojnë shprehjen: nuk kemi kapacitete teknike, sepse minimalisht duhet një hidroteknik në bashki dhe për këtë arsye ata e konsiderojnë këtë si një hallkë shtesë, duke pasur parasysh organikën që ka bashkia pasjen e një hidrotekniku e të tjera.

Me Komitetin Kombëtar të Digave mund të sigurohet një informacion, ose raporti vjetor që është bërë për 17-ën, më i detajuar rreth situatës së digave, qoftë të digave që janë në administrim të KESH-it, të atyre që janë në administrimin e shoqërive private apo të pushtetit vendor dhe më pas Komiteti Kombëtar i Digave lë detyrat e veta për bashkitë. Informacion më të plotë mund të japë vetë Komiteti Kombëtar i Digave nëpërmjet kryetarit ose strukturave që do të kërkonin ju.

Besnik Baraj – Desha të bëj edhe një ndërhyrje, të sjell një shqetësim, sepse shpeshherë bashkitë, siç është rasti i Bashkisë së Tiranës, në periudha të caktuara, për mua nuk ka rëndësi koha e Erion Veliajt apo e Lulzim Bashës, kanë probleme dhe ky komitet normalisht duhet të vendosë veton në lidhje me ndërtimet që bëhen poshtë digave. Fjala është për digën te liqeni i Tiranës, ku po bëhen ndërtime dhe ka pasur shqetësime nga pikëpamja mjedisore, por ajo që për mua është kritike është se çfarë risku kanë ato ndërtime nëse ndodh diçka me digën. Në këtë rast për mua komiteti i digave ose ju si ministri ose Ministria e Bujqësisë duhet të ketë një zë të veçantë determinues që kushtëzon ndërtimin ose të objekteve të kësaj natyre dhe jo të merren vendime politike ku nuk konsiderohen aspekte të rëndësishme shkencore.

Eduard Shalsi – Ju lutem, kolegë deputetë, të ezaurojmë se ku konsiston marrëveshja dhe pastaj te pjesa e diskutimeve mund të thoni mendimet tuaja.

Fatos Bundo – Unë jam drejtori i projekteve, që menaxhon projektet e Bankës Botërore në lidhje me sigurinë digave. Unë dua të bëj një sqarim. Kur flasim për projektin e sigurisë së digave, nuk do të thotë vetëm rehabilitimi fizik i digës, por, sipas ligjit në fuqi, diga ka edhe nën objektet e saj, pra flasim për monitorimin e digave, flasim për punimet elektromekanike, rehabilitimin e turbinave, që janë pjesë përbërëse e digës së njërit prej hidrocentraleve. Është e vërtetë, siç thotë zoti Baraj, se projekti i sigurisë së digave ka filluar në vitin 2012, procesi i parë i financuar nga Banka Botërore ka kapur shifrat e 39,4 milionë eurove dhe 2,6 milionë euro janë propozuar në këtë marrëveshje që do të bëjmë sot. Pra, për aktivitetin e parë shtesë, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, është vetëm 2,6 milionë euro. Pjesa tjetër, sipas projektligjit që është propozuar sot, është për një aktivitet të ri që është nënobjekt i digës, flasim për portat e shkarkimit, pra nuk ka pasur një investim më parë që të quhet financim i parë dhe tani është financim i dytë. Sot ne, nëse do të kalojë ky projektligj, flasim për rehabilitimin e portave të shkarkimit në hidrocentralet e Fierzës dhe të Komanit, që asnjëherë që nga koha e ndërtimit të tyre nuk kanë pasur rehabilitim, pra janë përdorur 40 vjet, nuk janë hapur asnjëherë, për shembull, porta nr.3 në Fierzë është në gjendje kritike dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme. Pra, pavarësisht se tipi i marrëveshjes është “financim i dytë” për aktivitetin e portave të shkarkimit nuk ka pasur financim tjetër dhe ta sigurojmë këtë si financim shtesë.

Në lidhje me pjesën tjetër të marrëveshjes, pra flasim për 2,6 milionë euro, 2 turbinat në Koman që mbarojnë në shkurt të vitit që vjen pra brenda 12-shes është 2,6 milionë euro që do t’u faturohen turbinave nr.1 dhe 4 në Koman dhe përmbushet përfundimisht rehabilitimi i 4 turbinave të Komanit, si dhe një sistem tepër modern monitorimi elektronik, i cili bën komandimin e tyre nëpërmjet sensorëve, i cili është vënë sot në eficiencë, sepse dy turbinat janë të përfunduara dhe deri më 20 shkurt është planifikuar komisionimi i dy turbinave të tjera të mbetura në hidrocentralin e Komanit. 1 milion euro në këtë marrëveshje është parashikuar supervizioni i punimeve për këtë 2.6 milionë edhe për pjesën 9 milionë euro që do të financohen në portat e shkarkimit. Pra, për një periudhë 30-mujore do të kemi konsulentin teknik që do të asistojë në supervizionin e punimeve dhe panelin e ekspertëve që financohen nga Banka Botërore. Janë 3 ekspertë të pavarur, të cilët janë të mirënjohur si akademikë, njëri kanadez, kinez dhe tjetri grek, profesorë të njohur, të cilët asistojnë në të gjithë projektin e sigurisë së digave, që janë parashikuar në marrëveshjen bazë.

Në lidhje me marrëveshjen me Gjermaninë, ajo është e firmosur dhe është vënë në zbatim, por nuk flasim për hidrocentralin e Komanit dhe të Fierzës, por po flasim për hidrocentralin e Vaut të Dejës. Pra, 20 milionëshi i financuar nga qeveria gjermane e ka filluar financimin, 17 milionë që u takon portave të shkarkimit dhe të remontit të HEC-it të Vaut të Dejës dhe 3 milionë euro do të ndërtohet një qendër dispeçer monitoruese për të gjithë kaskadën e Drinit, që do të thotë se do të komandohet nga një qendër moderne si HEC-i i Komanit, si ai i Fierzës dhe hidrocentrali i Vaut të Dejës. Marrëveshja me Gjermaninë është në zbatim, janë lidhur kontratat dhe pritet që brenda 28 muajve edhe ky financim të përfundojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E vetmja ndërhyrje që është bërë në kaskadën e Drinit është përfundimi nga Berzhi i 6 milionë eurove në digën e Komanit. Kjo tashmë ka përfunduar. Diga e Komanit është totalisht e rehabilituar fizikisht, jo si agregat, por si digë fizike. Nuk kemi probleme as në Fierzë dhe as në Vaun e Dejës. Këto janë tri HEC-et e mëdha që janë në kaskadën e Drinit.

Eduard Shalsi - Ka diçka për të shtuar ndonjëri prej panelit të të ftuarve para se të hapim siparin e pyetjeve?

Zonja nga Komiteti i Digave, doje të shtojë diçka?

Rolanda Hila - Do të thosha që në relacionin e paraqitur të cilësohen disa gjëra në lidhje me shkarkuesit, meqenëse ne kemi lidhje me sigurinë e digave si Komitet Kombëtar i Digave, po flas edhe si specialiste në sektorin e digave.

Për shembull, në financimin e të gjithë aktivitetit të rehabilitimit të portave dhe shkarkimit në HEC-in e Fierzës duhet të paraqitet një projekt. Nuk e di nëse është bërë ky projekt që të marr edhe një aprovim edhe te Komiteti i Digave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pyes në përgjithësi, sepse janë bërë shumë marrëveshje, të cilat janë mbyllur dhe tani po hapet një tjetër marrëveshje huaje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatos Bundo – Projekti është miratuar që kur është miratuar në parim i gjithë projekti i sigurisë së digave në vitin 2012 dhe Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha është pjesë përbërëse e këtij paneli, domethënë të gjitha këto kanë kaluar në miratimet respektive që para se të fillonte financimin. Ka qenë kusht i Bankës Botërore, të gjithë aktorët të ishin..

Eduard Shalsi - Më falni që po ju ndërpres!

Ju jeni zonja Rolanda Hila, apo jo? Gëzoni statusin e specialistes në sektorin e digave. Komiteti i Digave nga varet?

(Diskutim pa mikrofon)

Pra, varësinë ligjore e ka nga Këshilli i Ministrave, ndërkohë që *daily bussines* e bën menaxhimin me ministrinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord! Meqenëse jeni për herë të parë ndoshta në parlament, duhet të kuptoni, është anormale dhe e pazakontë që në mes të panelit, t'i drejtojmë pyetje njëri-tjetrit. Pse është e pazakontë? Sepse presumohet që ju atje jeni në bllok dhe pyetjet që keni mes njëri-tjetrit i keni ezauruar para se të vini këtu. Dakord?

Çka do të doja t'i thosha titullares së ministrisë, nga pikëpamja hierarkike zëvendësministres, të rakordohet paraprakisht me panelin, para se të vihet në komision, sepse me të drejtë kolegëve të mi mund t'u lindin pyetje për shkak të ndoshta mosrakordimit paraprak. Pra, me ekipin duhet ulur paraprakisht, duhen ezauruar pyetjet dhe pastaj një institucion t'i drejtojë pyetje një institucioni tjetër para se të vijnë me marrëveshjen. Dakord?

Komiteti Kombëtar i Digave, çfarë titullari ka?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka një kryetar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Sigurisht, zgjidhet po nga Këshilli i Ministrave, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Mbaje pak shënim, të lutem, pjesën e Komitetit të Digave, se ndoshta mund të zhvillojmë një takim. Ndërkohë, mjediset e punës janë te ministria, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Në lidhje me marrëveshjen, a ka ndonjëri prej panelit diçka tjetër për të shtuar para se t'ua jap fjalën kolegëve për të bërë pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave a keni diçka për të shtuar? Nuk keni ndonjë merak? Në rregull.

Atëherë, fjalën e ka zoti Beqaj dhe pastaj zoti Leka.

Ilir Beqaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Po u kthehem edhe një herë pyetjeve për vlerat e financimit, se, në fakt, të paktën siç është e shkruar këtu, ky i bie të jetë financimi i tretë, sepse shtesa e dytë i bie të jetë e treta si financim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për nga mënyra si është shkruar këtu.

Kështu që, sa ka qenë financimi i parë dhe sa ka qenë shtesa e parë? Kjo e dyta është 12, që e kuptoj.

Në vijim të kësaj, në qoftë se dikush ka informacion, a ka ngelur ende nga e tëra ndonjë financim që nuk është ende i mbuluar, në qoftë se ju keni bërë një vlerësim të plotë të sigurisë së digave, sipas përkufizimit tuaj, në çimento, beton, agregat, nën diga, llum e të tjerë?

Megjithëse dua ta saktësoj mënyrën se si e kuptova, kam një pyetje për konsulentin e implementimit dhe të panelëve të ekspertëve, por, Fatos, më korrigjoni, ju thatë: “Supervizioni është 1 milion, ndërkohë që punimet janë, në mos gabo, 11,6, nga të cilat 9 dhe 2,6”.

(Zoti Bundo flet pa mikrofon.)

Sa janë, atëherë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra.

Eduard Shalsi – Ndizeni pak mikrofonin, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir, e mbarove, që t’ia japim të drejtën të përgjigjet?

Ilir Beqaj – Jo, kam edhe një pyetje tjetër.

Eduard Shalsi – Atëherë, zoti Bundo, mbajini shënim pyetjet që t’u përgjigjeni pastaj të gjithave.

Ilir Beqaj – Në hesapin e parë supervizioni më doli 8,6, që është një tarifë. Do t’i tërheqim vëmendje komisionit në qoftë se pranojmë ose jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë, se do ta jepni përgjigjen!

Ilir Beqaj – Prandaj e kërkoja atë.

Në qoftë se dikush mund të më japë një përgjigje, dua të di si do të matet objektivi i dytë i projektit? Në relacion vrojtimi i dytë thotë: “Rritja e sigurisë dhe e cilësisë së furnizimit me energji elektrike, nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të efikasitetit”. A ka ndonjë tregues sa e kemi sot? Pas gjithë këtij investimi, përveç aspektit të sigurisë, që është shumë i

rëndësishëm, se po të çahet ndonjë gjë atje shkon në burg, por edhe efienca... Pra, si do ta matim që, kur të mbarojë ky projekt, të themi: pas këtij investimi, përveç sigurisë, kemi (nuk e di, me çfarë i matni ju ato) nivelin e humbjeve sot në prodhim, dhe sa do të na kursejë kjo mundësisht, në qoftë se dikush mund të na ndihmojë sot e ditët më vonë, e përkthyer në para: kaq megavatë orë humbasim sot nga mosfunksionimi i saktë i portave dhe i aggregateve, kursejmë në vit kaq megavat orë me një çmim mesatar që ka KESH-i i miratuar nga ERE. Sa i bie interesi? Në mos gaboj...

Për këtë çështje nuk kisha pyetje të veçantë, kryetar, veçse mendoj se problemi i digave është i komplikuar pak, sepse Komiteti i Digave ka edhe sigurinë, edhe menaxhimin.

Digat e Ulzës dhe të Shkopetit hapen sipas Kurumit dhe jo më sipas interesit kombëtar hidroenergjetik. 4-5 vjet më parë Ulza shërbente më shumë si rregullator i Drinit, ndërsa sot është vetëm interes privat i atij që e ka marrë, i cili sigurisht, do ta shfrytëzojë për vete. Kjo lidhet pak me atë që kemi përcaktuar në rezolutën e ERE-s dhe kam përshtypjen se ka ardhur momenti të rishikohet menaxhimi i digave. Ajo që hidhet sot në rrjet nga kaskada varet nga privatët. Vitin tjetër Devolli do të jetë i plotë dhe kështu, do të ndryshojnë të gjithë ekuilibrat.

Vijmë përsëri te digat. Ndoshta me Komitetin e Digave mund të bëjmë ndonjë dëgjese.

Eduard Shalsi – Dakord.

E kam mbajtur shënim dhe do ta bëjmë një diskutim me ta. Ose do të vijnë ata këtu ose do të shkojmë ne te Komiteti i Digave. Kështu, këto shqetësime, që nuk është hera e parë që ngrihen me shumë të drejtë, do të na duhet t'i diskutojmë për të parë nëse po përgatitet ndonjë ndryshim në konceptin e organizimit, të kontrollit, të menaxhimit dhe të monitorimit të digave. Pra strukturat aktuale i përgjigjen aktualitetit apo janë demode? Shqetësimi nëse duhet, është prezent dhe duhet ta shoh me vëmendje.

Zoti Leka, fjala për ju.

Edmond Leka –Faleminderit, kryetar!

Edhe unë në vazhdim të shqetësimeve që ngriti zoti Beqaj, kisha pothuajse të njëjtat pyetje. Dua t'u kërkoj përfaqësuesve të ministrisë të na japin një situatë të gjendjes së digave sot, është alarmante apo ka nevojë për ndërhyrje?

Pyetja tjetër lidhet me 12 milionë eurot investime shtesë. Këtu u fol vetëm për 1 milion euro, që kanë të bëjnë me supervizimin dhe 2,6 milionë euro për investimet për riparimin e portave. A mund të na japin përfaqësuesit detaje për buxhetin prej 12 milionë eurosh se si do të përdoren?

Eduard Shalsi – Para se të përgjigjeni, dua të shtoj diçka. Lidhur me situatën e digave, ne do të organizojmë një vizitë te Komiteti ose do ta ftojme kryetarin e komitetit. Specialistja duhet ta mbajë shënim dhe ta lajmërojë që komisioni do të vijë për një vizitë, në mënyrë që të na bëjnë një paraqitje të situatës së digave. Kështu që atë do ta ezaurojmë në takim.

Po, zoti Suli.

Rakip Suli – Në fund të këtij relacioni thuhet se projekti është pjesë e parashikimeve të buxhetit të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare për periudhën 2018-2021. Meqenëse kjo huamarrje është parashikuar në buxhetin e kësaj korporate, fatura ekonomike e këtij investimi bëhet nga korporata apo nga huamarrjet që marrim herë pas here?

Fatos Bundo – Atëherë, po e filloj nga detajimi i shumës së marrëveshjes që ne po diskutojmë sot. Ne flasim për 12 milionë euro në të gjithë këtë projekt, e cila është e ndarë në 2,6 milionë euro, jo për portat e shkarkimit, por për rehabilitimin përfundimtar të turbinave numër 1 dhe numër 4 në HEC-in e Komanit. Ky rehabilitim ka pasur financimin e parë. Kjo është në përgjigje të zotit Beqaj. Po them se ky nuk është financimi i tretë dhe ju garantoj për këtë punë. Marrëveshja është firmosur në vitin 2012 dhe kap vlerën e 39 milionë eurove dhe ka pasur 5 komponentë: rehabilitimi i të gjitha turbinave në HEC Koman; rehabilitimi i digës në HEC Koman; modernizimi i monitorimit të digës HEC Koman, domethënë në sizmikë, në hidrologji, në rrjedhje, si dhe financimi i supervizionit të këtyre punimeve. Pra, sot në po flasim për financimin e dytë dhe jo për të tretin. Terminologjia e përkthyer nga anglishtja *Second Addition Financing* mund të korrigjohet. Ky është financimi II. Nuk ka pasur financim të tretë.

Kur themi se siguria e digave ka pesë komponentë, rehabilitimi i portave të shkarkimit ndodh për herë të parë. Nuk ka pasur financim të mëparshëm dhe tani flasim për shtesë financimi të portave të shkarkimit në HEC Koman dhe Fierzë. Është rehabilitimi i parë bazuar mbi një studim që është bërë që në vitin 2009 nga kompani të mirënjohura zvicerane dhe për të gjithë sektorin elektroenergjetik ka nxjerrë pikat se ku duhet të ndërhyhet.

Një pyetje tjetër që bëri zoti Beqaj është për rehabilitimin e portave të shkarkimit. Ka një eficiencë jashtëzakonisht të madh pas rehabilitimit, pasi çdo portë shkarkimi që kemi sot, flasim për katër porta shkarkimi, dy në Fierzë dhe dy në Koman, kemi humbje dy mega në ditë vetëm nga rrjedhjet. Kjo përkthehet në para, por më tepër se në para, rrjedhjet e portave të shkarkimit prishin qetësinë e digës, sepse rrjedhjet nën bazamentin e digës dhe nëpër tunelet e digës e prishin qëndrueshmërinë e digës dhe kjo është shumë herë më e rëndësishme se vetë humbja në mënyrë mekanike e dy megave çdo ditë. Të gjitha portat e shkarkimit,

nga që kanë 40 vjet pa u prekur me dorë, pa bërë rehabilitim, rrjedhin në mënyrë të tejskajshme, jashtë normave që kanë. Si shoqatë simotër për Komitetin Kombëtar, kemi Shoqatën Ndërkombëtare të Digave të Mëdha dhe në çdo kongres flitet për rrezikshmëri, në qoftë se rrjedhjet e portave ose të digës janë mbi 800 litra për sekondë. Sot në digën e Komanit ka katër herë më shumë. Pra, rrezikshmëria e qëndrueshmërisë së digës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Maksimumi lejohet sipas Komitetit Ndërkombëtar të digave të mëdha. Domethënë, sipas studimeve të bëra, sot në digën e Komanit humbjet e portave të shkarkimit janë katër herë më shumë. Pra, përveç parave që ne humbim në prodhimin e energjisë, kemi edhe humbje në prishjen e digës. Kjo do të thotë se 200 deri në 250 mijë njerëz janë të rrezikuar çdo sekondë në qoftë flasim për një prishje të mundshme të digës që nuk duhet të ndodhë. Kjo është përgjigjja më e detajuar lidhur me vlerën prej 12 milionë që ju pyetët.

1 milion euro është supervizimi i agregateve dhe periudha kontraktuale do të zgjasë 28 muaj, e cila do të shërbejë për rehabilitimin e portave të shkarkimit. Në këtë projekt do të marrin pjesë shumë ekspertë, sepse flasim për inxhinierë elektrikë, mekanikë, hidroteknikë, gjeologë. Pra, nuk po flasim vetëm për një individ, por do të jenë një grup ekspertësh supervizorë, të cilët do të mbikëqyrin punimet për një periudhë 28-mujore, që është edhe parashikimi kontraktual. Mund të ndodhë që të ketë shtesa, por përsëri kam bindjen se kjo shumë, sipas normave, nuk është e madhe. Pra, nuk bëhet fjalë vetëm për shumën 9,6 milionë për supervizionin, siç e kuptoi zoti Beqaj, por janë 1 milion në 18 milionë, që është i gjithë investimi, ku 12 milionë janë dhënë nga Banka Botërore, që kemi sot, dhe 6 milionë euro i kemi në gjendje nga BERZH-i për rregullimin e portave të shkarkimit në Fierzë dhe në Koman.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër! Ky është edhe qëllimi, sepse ka qenë një kusht i Bankës Botërore, që zbatimi i projekteve për sigurinë e digave duhet të shoqërohet nga 3 panele ekspertësh, që do të jenë të pavarur. Pra, këta ekspertë nuk do të jenë të varur as nga KESH-i dhe as nga Banka Botërore, por do të jenë ndërkombëtarë, të cilët do të kenë si misionin monitorimin dhe çdo 3 muaj do të japin raportet e tyre respektive, në mënyrë që ne të marrim masat.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pa diskutim! Ne jemi brenda parametrave.

Eduard Shalsi – A ka ndonjë gjë tjetër?

Dorina Cinari – Dua t'i përgjigjem pyetjes që bëri zotëria, nëse ka financime nga buxheti i shtetit. Po, ka financime.

Tedi Bushaj – Në lidhje me planin afatmesëm buxhetor, që ju nënvizuat, marrëveshja është e përjashtuar nga çdolloj detyrimi doganor dhe çdo lloj takse që financon Banka Botërore. Sigurisht që kjo shumë kundrejt shumës së financuar nga Banka Botërore duhet të jetë e planifikuar në buxhetin e KESH-it dhe kjo është e mbuluar totalisht. Pra, kësaj shume do t'i shtohen të gjitha taksat e tjera dhe detyrimet që do të marrë qeveria Shqiptare ose KESH-i.

Eduard Shalsi – Dakord, ju falënderoj për shpjegimet.

Ne do të votojmë marrëveshjen e sotme, por edhe marrëveshjen e djeshme, megjithëse e kemi votuar, por për efekt mosregjistrimi jemi të detyruar ta rivotojmë.

Kalojmë në votimin e marrëveshjes së sotme “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave”.

Në parim kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në tërësi. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Votojmë edhe një herë marrëveshjen e djeshme, për efekt mosregjistrimi. Projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt, Main (KfW), për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efikasitetit të energjisë, faza II”

Në parim kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në tërësi. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Nesër kemi për të bërë një vizitë te shoqëria “Albkontroll” dhe do t’ju njoftojmë në orët në vijim nëse do ta bëjmë.

Mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA